



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 2154/1 Prot.

Vlorë më, 29.07.2026

VENDIM

Nr. 37, datë 29.07.2026

**PËR MIRATIMIN E MODALITETEVE TË ZHVILLIMIT TË SEZONIT TË VERËS
DHE PROPOZIMIN DREJTUAR BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË TARIFAVE PËR
ZHVILLIMIN E TIJ, PËR VITIN AKADEMIK 2025–2026**

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 19, pika 1, shkronja "e", të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 87, pikat 10, 11 dhe 13, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; si dhe bazuar në Vendimin e Rektoratit nr. 18, datë 20.07.2026, "Për miratimin e zhvillimit të sezonit të verës dhe propozimin drejtuar Senatit Akademik të modaliteteve të zhvillimit të tij, për vitin akademik 2025–2026", Senati Akademik, në mbledhjen e datës 29.07.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë modalitetet e zhvillimit të sezonit të verës për vitin akademik 2025–2026, sipas propozimit të Rektoratit, miratuar me Vendimin nr. 18, datë 20.07.2026, "*Për miratimin e zhvillimit të sezonit të verës dhe propozimin drejtuar Senatit Akademik të modaliteteve të zhvillimit të tij, për vitin akademik 2025–2026*"
 2. T'i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e tarifave për zhvillimin e moduleve gjatë sezonit të verës, si më poshtë:
 - për grupet me 1 (një) deri në 2 (dy) studentë, tarifa të jetë 10.000 (dhjetë mijë) lekë për student, për çdo modul;
 - për grupet me jo më pak se 3 (tre) studentë, tarifa të jetë 1.000 (një mijë) lekë për çdo kredit ECTS.
 3. T'i propozojë Bordit të Administrimit që të ardhurat e arkëtuara nga tarifat e zhvillimit të moduleve gjatë sezonit të verës të përdoren në masën 100% për pagesën e pedagogut që zhvillon modulin. Në rastet kur pedagogu pranon ta zhvillojë modulin pa pagesë, studenti të përjashtohet nga detyrimi për pagesën e tarifës.
 4. Ky vendim përcillet për miratim përfundimtar në Bordin e Administrimit.
 5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, dekanët e fakulteteve dhe Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakadematike.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

Konceptoi dhe punoi,
Koordinator i organeve kolegiale të UV-së, Gilberta Selami

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Faqe 1 nga 1



Ëeb-site: www.univlori.edu.al
e-mail: info@univlori.edu.al